



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit e Treg

Kamëz, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

## SPECIFIKA TË PËRGJITHSHME

**Identifikimi i duhur:** Pemët duhet të jenë të emërtuara duke ju referuar specifikimeve teknike dhe do të etiketohen individualisht ose në grupe sipas kultivarëve.

**Pajtueshmëria:** Të gjitha pemët duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Drurë (pemët) duhet të jenë të shëndetshme, pa sëmundje apo problematika të tjera dhe duhet të jene te shoqeruara me çertifikatat e inspektimit të kërkuara me ligj.

**Inspektimi:** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të refuzojë drurët (pemët) që nuk plotësojnë specifikimet teknike.

### TRANSPORTIMI I DRURËVE

Drurët normalisht duhet të furnizohen në vazo, në varësi të kërkesave teknike dhe specifikimeve të formuluar nga ana e grupit të specifikimeve teknike, vazot të jenë proporcionale me përmasat e bimës.

Për drurët e furnizuar me vazo, duhet të jenë të mbjella në formë kompakte, materiali organik duhet të jetë i ngjitur mirë me rrënjët, pa çarje të dukshme në strukturë në mënyrë të tillë që të mos përbëjë një rrezik të mundshëm asfiksimi.

**Te ilustruara me skica sesi duhet te jete sistemi rrenjesor i pemeve:**

**Figura nr.1**



**Figura nr.2**




Figura nr.1 dhe Figura nr.2 demonstronë si **nuk duhet** të jetë rrënja e pemës e vendosur në vazo

### **Figura nr.3**




Figura nr.3 tregon një sistem rrënjësor të shëndetshëm.

### **MBJELLJA E DRURËVE**


Drurët duhet të plotësojnë kërkesat sipas secifikimeve teknike. Drurët duhet të jenë kultivuar posaçërisht për llojin e përdorimit të parashikuar. Degët e kërcellit dhe përbërësit kryesor të rrënjëve dhe trungut të jenë pa deformime, si p.sh kurora të deformuara, dëmtime të çdo origjine dhe lloji, dëmtime ose shenja të mëdha që vijnë nga goditjet, dëmtime nga fenomene natyrore si breshëri, dëmtime të lëvores (mungesë e lëvores), organizma të llojit kërudhë, djegie nga dielli, si dhe shkaqe mekanike.

Kurora duhet të jetë e degëzuar mirë, uniforme dhe e ekuilibruar, simetria duhet të jetë e rregullt dhe shpërndarja e degëve kryesore dhe dytësore të trungut e rregullt.

Sistemi rrënjor duhet të jetë i degëzuar mirë, i pasur me rrënjë kapilare të freskëta dhe të shëndetshme.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Pema vendoset përpjendikularisht, 30-40 cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjerë fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën nr.5


### **Figura nr.5**



*Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit\_pemës) figura nr.5*

Një shtresë me pleh organik, ndihmojn në mbrojtjen e rrënjëve të pemëve nga temperaturat ekstreme dhe gjithashtu bën të mundur ruajtjen e lagështisë së tokës. ndihmon në parandalimin e rritjes së barërave të këqinj dhe në përmirsimin e thithjes së elementëve të ushqyeshëm organik. Aplikimi i plehut organik duhet të kryhet në një thellësi prej 7 deri në 10 cm (me një sasi më të pakët përreth trungut, sipas figurës Nr.6.


**Figura nr.6**




Metoda e pozicionimit varet nga aftësia e drurit (pemës) të qëndroj vertikalisht pa ndihmën e pozicionimit të një dërrase mbështetëse, kjo mënyrë pozicionimi ndihmon drurin që të qëndrojë i drejtë në mënyrë vertikale, ndihmon rrënjët të zhvillohen si duhet, dhe gjithashtu ndihmon trungun nga dëmtime të mundshme.

Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri\_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjat e futur në tokë. Trupi i fidanit (druri\_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë amballazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve, sipas figurave nr.7 dhe nr.8.

**Figura nr. 7**



**Figura nr.8**



Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përçark saj formohet një unazë dhe e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë pema do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.

### **Specifikime Teknike me Foto Ilustruese:**

#### **Sqarim: Fotot kanë vetëm qëllim ilustruese.**



#### **1. *Patanus acerifolia*, (me perimetër 18 - 25 cm , 2.5 m nga toka) Në vazo**

Ne momentin e dorezimit pema duhet te kete nje perimeter 18 – 25 cm, lartesi afersisht 2.5 m, te jete e mbjelle ne vazo dhe trangu te mos kete asnje demtim.



#### **2. *Tilia platyphollos*, (me perimetër 18-25 cm , 2 m nga toka. Në vazo**

Ne momentin e dorezimit pema duhet te kete nje perimeter 18 – 25 cm, lartesi afersisht 2 m, te jete e mbjelle ne vazo dhe trangu te mos kete asnje demtim.

**Sqarim:** Numri total i bimësisë dekorative për magazinim është 933 copë drurë dekorative.

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

**Objekti:** Mbjellje pemesh + sherbim Drurësh Dekorativ

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi</b>
1	Patanus acerifolia, Rrap (me perimetër 18-25 cm, 2.5 m nga toka) Në vazo.
2	<i>Tilia platyphollos</i> , Bli (me perimetër 18-25 cm, 2 m nga toka) Në vazo.
3	Pleh organik

### **1. Preventiv Mbjellje në trotuar**

Lënda: Mbjellje drurë dekorativë.

<b>N/R</b>	<b>N/M</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	3,961	F.V. fidane peme dekorative Rrap (Patanus acerifolia P=18-25 cm)	copë	618
2	3,966	F.V. peme dekorative Bli ( <i>Tilia platyphollos</i> P=18-25 cm)	copë	315
3	AN	Pleh organik	kg	1812,6
		Shuma		
		TVSH 20%		
		<b>TOTALI</b>		

**Spec.Mjedisi :** Odise Matraku

**Spec.Mjedisi :** Emanuela Prendi

**Spec.Mjedisi :** Brikena Shira